

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE DATA 2 MARS 2023

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pa diskutim që debati i sotëm është thelbësor në shumë drejtime. Është thelbësor për të hedhur dritë përfundimisht mbi një ngjarje të rëndë, të ndodhur, dhe për pyetjen e madhe se çfarë Kryeministri kemi, së pari? Së dyti, çfarë parlamenti kemi? Së treti, çfarë institucionesh sigurie kemi? Dhe së katërti, a kemi ne një shtet të balancuar, ku balanca dhe kontrolli veprojnë dhe ku rojtari i madh është ligji dhe institucionet e drejtësisë? Kjo ngjarje nxori në shesh dhe iu dha përgjigje të gjitha këtyre pyetjeve. Çfarë tregoi së pari, aq më tepër për zemërcjerrët, të cilët flasin shpesh në emër të SHBA-ve dhe për fatin e zi, e shpërdorojnë në mënyrë të neveritshme fjalën “SHBA”-të? Përtej fjalëve të bukura, retorikave, propagandës, që është më tepër propagandë, që vjen erë shumë të keqe, realiteti është ky dhe përballë kemi një çështje: në SHBA një drejtor i zbulimit është vërtetuar qartë për veprimtari korruptive dhe të tjera elemente, mbase më të thella, por është puna e tyre. Çfarë bëjnë SHBA-të? Janë në këmbë të gjithë dhe hetohet me të gjitha instrumentet që kanë. Parlamenti i tyre, Kongresi, është në këmbë, ka ngritur komisionin hetimor menjëherë, jo si te ne, ku teoricienët e këtushëm, teoricienët demagogë dhe akomodues të frikërave të Kryeministrit, pezullojnë komisionin hetimor.

Pra, çfarë na tregojnë SHBA-të? Na tregojnë se këtu kemi një parlament renegat, në raport me një parlament të përgjegjshëm atje përtej oqeanit. Çfarë ndodh tjetër? SHBA-të vënë në dispozicion të gjitha instrumentet e tyre që të hidhet dritë mbi veprimtarinë e atyre që shërbejnë në detyrat shtetërore. Po këtu, çfarë bëhet? Mobilizohet një parlament i tërë që të ndërtojë me të gjitha mundësitë që ka një alibi, që nuk rri dot gjëkund, për të mbrojtur një Kryeministër të kapur me presh në dorë; për fat të mirë, e citoi 10- 14 herë si preshi ishte kapur në dorën e tij. Pra, gjysma e parlamentit është e gjitha e mobilizuar të krijojë alibi dhe të ndërtojë gjithçka për të akomoduar frikën e përgjegjësive shumë të rënda që rëndojnë mbi Kryeministrin. Çfarë bën Kongresi amerikan? A e refuzon hetimin? Jo, absolutisht. Në mënyrë automatike, me mirëkuptim të jashtëzakonshëm, të padiskutueshëm, po të njëjtën gjë bën edhe senati, e ngre komisionin hetimor. Po ku është shumica jonë parlamentare, ku janë proamerikanët, zemërcjerrë për Amerikën? “Jo, jo se ne do të ndryshojmë një ligj dhe, kur ta ndryshojmë atë ligj...”, besoj do t’u vijë turp kujtdo, të paktën atyre që kanë bërë shkollën për drejtësi, që pajtohen e nuk dalin kundrejt këtij arsytimi të fëlliqur, që minon kontrollin e parlamentit, minon republikën parlamentare, qenien e këtij vendi dhe këtij sistemi shoqëror, të cilit në momentin që i minohet kontrolli, nuk është gjë tjetër veçse një demokaturë e pështirë, pa bazament, thjesht dhe vetëm një mafie, e cila përpiqet të fshihet pas instrumenteve demokratike. A mund ta mohojë dot njeri që pjesa më qesharake duan të na e paraqesin si normalitet dhe të na e mbushin mendjen që instrumentet shtetërore, të korrektesës shtetërore, të komunikimit shtetëror do të fshihen pas arsytimit: “A mund t’i thoshim ne jo një zyrtari amerikan, apo lloj-lloj privati që kërkon takim, që na kërkon të ndajmë sekretet që këtu deri në Kukës...”? Ky njeriu i zbulimit amerikan, i FBI-së, që bëhet si një hero folklorik popullor, njeriu i sekreteve dhe i shërbimit, që nuk ka lidhje fare, argaliset me njerëzit; deputetë lloje-lloje, ish-ministra, që nuk kanë asnjë lidhje me këtë punë,

argalisen, hanë mish, madje bëhet qytetar nderi atje, me justifikimin se “na ka thënë ai dhe nuk mund t’i thoshim jo atij amerikanit. Po çfarë është kjo? Kjo është një faqe e zezë. Pse, nuk e di njeri? Kaq të pacipë e konsideroni veten? Pse, nuk e di njeriu se në çfarë mënyre komunikohet me njerëzit që kanë detyra të caktuara, që kanë një diskrecion të caktuar për detyrat e caktuara dhe që nuk mund të jenë, absolutisht, objekt komunikimi në 99% të tyre, sepse objekti është shumë i qartë, sepse shteti është ndërtuar i tillë, mënyra e drejtimit të informacionit të rezervuar është e tillë. Po çfarë është ky? Ky është thjesht dhe vetëm heroi folklorik popullor, i cili na ndihmon të bëjmë “standardin ndërkombëtar të Kryeministrit”, që u çor këtu me gjestikulacione, me marrje fryme, me djersë, që na thotë të mos shajmë anglisht, kurse, për vete thotë: “Unë, jo vetëm do të shaj, por do të shpif, do të shkruaj dhe do të paguaj para dhe do t’i çoj anglisht të tëra!”. A mbrohet ky demagog?! A keni stomak? Mbrojeni! Po të vërtetat ulërijnë në mes të sheshit. Çfarë na tregoi tjetër? Na tregoi nëse kemi drejtësi të reformuar. Në letra e kemi dhe për ta paguar e paguajmë sa qimet e kokës, por si është drejtësia sot? Është pa gojë, pa sy, pa veshë dhe pa dorë që të shkruajë. Është tundur Amerika, heton për një drejtor, ndërsa këtu kemi Kryeministrin në thes dhe nuk lëvizin gishtin. Kishim një drejtësi që vepronte pak, me avash, por e shkëmbyem me një drejtësi të reformuar që nuk vepron fare. Kushdo që do të duartrokasë për këtë drejtësi, po, është i lumtur në këtë krah, se fajtorët nuk ndiqen. Edhe Kryeministri është shumë i qetë, se e di që kjo drejtësi nuk ka punë me të. Ata ngrihen në këmbë për një drejtor, këtu nuk lëviz absolutisht asgjë; lëviz shpejt për atë arkën e sardeleve, lëviz për atë, por jo këtu ku, sa herë të gugëlloni del: Edi Rama me McGonigal, histori korruptimi mbarëbotërore.

Nëse keni stomak, mbrojeni, por nuk futet minarja në xhep asnjëherë. Po organet e sigurisë kombëtare të vendit ku janë, ku ndodhen? A u shqetësuan ndonjë çikë organet e sigurisë kombëtare që një njeri i zbulimit, shumë i identifikuar, merr takime lloje-lloje, me lloje-lloje personazhesh të mazhorancës, që nuk kanë lidhje fare me të, që nuk kanë lidhje me sekretet e FBI-së?! Nuk u shqetësuan?! Nuk komunikuan me homologët e tyre të sigurisë amerikane, me ata që natyrshëm kanë funksion dhe detyrë për t’u lidhur?! Nuk u merakosën fare, apo sigurisht, këtu është han pa porta; han pa porta për drogën, han pa porta për kontrabandën. Për këta është krenari e madhe që është bërë mbretëria e narkotrafikut në Europë, mbretëria e pastrimit të parave, han pa porta. Po çfarë bëjnë institucionet e sigurisë? Pse i paguajmë? Përse i paguajmë, të rrinë nëpër vrima dhe rrëza dhe të bëjnë foto se kush del në mitingjet e opozitës?! Kjo është siguria?! Këta organet e sigurisë dhe të rendit, një kriminel, një maskara, një qen bir qeni që vret tri gra dhe rehat-rehat vjen vërdallë me makinë në mes të Tiranës, nuk e gjenin dot. Por, atë protestuesin më të fundit, atje në vrimë të miut, e gjejnë menjëherë këta. Ne ishim në mëshirë të atij që vendosi të vrasë tre, se mund të vriste edhe më shumë. Këto janë të vërtetat. Po çfarë bëjnë këta? Këta rrahin gjoksin për sukseset e mëdha, nga fitorja në fitore. Kështu ishte rasti i këtij. Pra, mund të lëvizë pa kufij, pa asnjë problem, ndërkohë që çdo njeri, ngado që të vijë, nuk ka status të privilegjuar, ka raportin me detyrën, më korrektesën. Të vijë nga Amerika, nga Azia, nga Afrika, nga të dojë, raportet me korrektesën shtetërore të vendit, me të gjitha duhet t’i ketë në rregull. Por ne kemi Kryeministrin që thotë: “Unë me një sms takohem, nuk e kam problem fare, unë e refuzoj parlamentin, vij kur të dua vetë”. Dhe na flet për Amerikën, na rrëfen non grata-t, ky refuzuesi i parlamentit. A guxon njeri ta bëjë këtë? A guxon Prokurori i Përgjithshëm i Amerikës të mos shkojë? Kush guxon të refuzojë në Amerikë? Por ky guxon, sepse mendon: kam nja 70 e ca vota në xhep, i telekomandoj, dhe ata më mbrojnë nga çfarëdolloj turpi që unë bëj. Kështu që afera “McGonigal” i vuri pikën asaj, se ju keni mbaruar së ekzistuari si përfaqësues të Kushtetutës dhe të ligjit në parlament, dhe jeni thjesht dhe vetëm ca instrumente për të bërë një alibi të një njeriu që i ka mbyllur punët e tij shtetërisht, kushtetutshmërisht dhe moralisht, por është si çdo agoni: ka nevojë t’i asistojë dikush, t’i qajë te koka, dhe po i qani ju